

VENDIME JASHTË MBLEDHJEVE TË BORDIT

Vendimi 2021-K01

Data: 19.03.2021

Shtyrja e turneut “Kalaja Juniors 2021-U12”

- Kryetari në konsultim më referin dhe organizatorin e turneun “Kalaja Juniors 2021 – U12” merr vendim të shtyjë turneun, i cili ishte planifikuar të mbahet më 20-21 mars 2021, si pasojë e motit të ftoftë dhe kushteve të pavolitshme për zhvillimin e meçeve.

Vendimi 2021-026

Data: 19.03.2021

Emërimi i z. Naim Shehu- Kapiten i Davis Cup

- Bordi me shumicë votash miratojnë propozimin e Kryetarit Jeton Hadërgjonaj për emërimin e z. Naim Shehu kapiten për Davis Cup 2021.

Vendimi 2021-027

Data: 19.03.2021

Emërimi i znj. Blearta Ukëhaxhaj- Komisionere e Garave

- Bordi me shumicë votash miratojnë propozimin e Kryetarit Hadërgjonaj për emërimin e znj. Blearta Ukëhaxhaj në postin e komisionerës së garave, pas dorëheqjes së pranuar nga znj. Mërgime Mula.
- Blearta zyrtarisht nis angazhimin më 22 mars, sipas kushteve të përcaktuara me kontratë.

Vendimi 2021-K02

Data: 20 mars 2021

World Tennis Conference

- Kryetari Hadërgjonaj merr vendim të mbështes trajnerët e certifikuar me Level 2 për pjesëmarrje në konferencën e parë botërore të tenisit e cila do të organizohet nga Shoqata e Trajnerëve Profesionistë të Tenisit (GPTCA) në mënyrë virtuale nga data 25-28 mars 2021.

Vendimi 2021-028

Data: 26 mars 2021

Hestorex world health, sport and alternative congress

- Bordi me shumicë votash marrin vendim që Kryetari Hadërgjonaj dhe Drejtori për Zhvillim z. Shkelzen Domi të marrin pjesë në kongresin “Hestorex world health, sport and alternative” që do të organizohet nga data 20-22 maj 2021 në Turqi.
- Shpenzimet e pjesëmarrjes në këtë event do të mbulohen nga vet organizatorët e HESTOUREX-it.

Vendimi 2021-029

Data: 16.04.2021

Rregullojra per Ranking

- Bordi me shumicë votash aprovon ndryshimet e pranuar nga grupi punues në rregulloren 04 për rankingun zyrtar.
- Rregullorja me ndryshime hynë në fuqi nga data e aprovimit (16.04.2021).